Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0826

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "AlbKos Safety" SH.P.K. kundër njoftimit mbi vendimin e Komunës Prizren në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare (projekt 3 vjeqar)" me numër te prokurimit:622-26-3081-2-2-1, me 25/11/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "AlbKos Safety" SH.P.K. me nr. 2026/0826, e datës 23/10/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare (projekt 3 vjeqar)" me numër të prokurimit: 622-26-3081-2-2-1.

2. Mbetet në fuqi, njoftimi mbi vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si në pikën 1 të këtij dispozitivi.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "AlbKos Safety" SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 07/05/2026, Komuna Prizren në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimi për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare (projekt 3 vjeqar)" me numër të prokurimit: 622-26-3081-2-2-1.

Me 12/10/2026, OE "AlbKos Safety" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23/10/2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "AlbKos Safety" SH.P.K. me nr. 0826/2026 lidhur me aktivitetin "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare (projekt 3 vjeqar)" me numër të prokurimit: 622-26-3081-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AlbKos Safety" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Në përputhje me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, paraqesim këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prizrenit, të datës 13.10.2026, përmes të cilit është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim në kuadër të aktivitetit të prokurimit me titull: „Mbushja dhe servisimi i aparateve për zjarrfikës për objektet e shëndetësisë primare (projekt 3-vjeçar)", me numër të prokurimit 622-26-3081-2-2-1.

SQARIM HYRËS

Në aktivitetin e lartcekur të prokurimit kanë marrë pjesë tre operatorë ekonomikë:

Nr.	Operatori ekonomik	Çmimi me TVSH
1.	PROGLOBAL SH.P.K.	33.729,00 €
2.	ALBKOS SAFETY SH.P.K.	32.844,00 €
3.	SAFETY 1ST L.L.C.	34.470,00 €

Më 21.07.2026, Autoriteti Kontraktues kishte përzgjedhur ALBKOS SAFETY SH.P.K. si tenderues të suksesshëm. Pas ankesës së operatorit ekonomik PROGLOBAL SH.P.K. dhe vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566, aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim.

Pas përfundimit të këtij procesi, AK-ja ka ndryshuar vendimin e mëparshëm, duke e konsideruar ofertën tonë të papërgjegjshme, me arsyetimin se nuk përmbushim kriterin minimal të përvojës profesionale, dhe ka propozuar shpërblimin me kontratë të OE PROGLOBAL SH.P.K.

Kundër vendimit të ri të AK-së, më 12.10.2026 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim, në të cilën kemi ngritur tri pretendime ankimore, të mbështetura me argumente juridike dhe prova

dokumentare.

Pretendimi i parë ankimor kishte të bënte me moszbatimin e plotë dhe efektiv të vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566, përkatësisht me moskryerjen e verifikimit të referencave sipas udhëzimeve të Panelit Shqyrtues dhe dispozitave përkatëse të LPP-së. Në mbështetje të këtij pretendimi kemi paraqitur referenca dhe dokumentacion për kontrata të realizuara, të cilat dëshmojnë përmbushjen e kriterit minimal të përvojës profesionale në vlerë prej 52.500,00 €. Gjithashtu, kemi kundërshtuar mënyrën e vlerësimit të referencave dhe mungesën e dëshmive për verifikimin e tyre pranë autoriteteve kontraktuese përkatëse.

Pretendimi i dytë ankimor kishte të bënte me paraqitjen e informacioneve të pasakta dhe çorientuese nga OE PROGLOBAL SH.P.K. lidhur me çmimet e ofertës sonë, veçanërisht për servisimin dhe mbushjen e aparateve P6 kg, P9 kg, P25 kg dhe P50 kg. Kemi paraqitur argumente teknike dhe ekonomike që kundërshtojnë kalkulimet e këtij operatori, duke evidentuar dallimin ndërmjet servisimit periodik dhe rimbushjes sipas nevojës, si dhe kundërthëniet ndërmjet pretendimeve të PROGLOBAL-it dhe çmimeve të paraqitura në ofertën e tij.

Pretendimi i tretë ankimor kishte të bënte me rrethanat që ngrenë dyshime për koordinim ndërmjet OE PROGLOBAL SH.P.K. dhe OE SAFETY 1ST L.L.C. Në këtë drejtim, kemi paraqitur dëshmi lidhur me lidhjet familjare dhe afariste ndërmjet personave që qëndrojnë pas këtyre operatorëve ekonomikë, si dhe rrethana të tjera që kërkojnë verifikim për të përcaktuar nëse ofertat dhe veprimet e tyre kanë qenë realisht të pavarura.

Megjithatë, duke marrë parasysh objektin e kësaj ankese dhe nevojën që shqyrtimi të përqendrohet në ligjshmërinë e vendimit të AK-së, heqim dorë nga pretendimet nr. 2 dhe nr. 3 të kërkesës për rishqyrtim si baza të pavarura të ankimit. Rrjedhimisht, ankesën aktuale e kufizojmë në dy çështje thelbësore, të trajtuara në kuadër të pretendimit të parë të asaj kërkese: moszbatimin e vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566 dhe eliminimin e pabazuar të ALBKOS SAFETY SH.P.K., si pasojë e vlerësimit të pasaktë dhe të paplotë të referencave.

Heqja dorë nga këto dy pretendime si baza të pavarura të ankimit nuk nënkupton tërheqjen e fakteve, argumenteve dhe provave të paraqitura në mbështetje të tyre.

Përkundrazi, konsiderojmë se këto fakte, argumente dhe prova duhet të mbeten pjesë e dokumentacionit të çështjes, si sqarime plotësuese që dëshmojnë mënyrën se si OE PROGLOBAL SH.P.K. ka paraqitur informacione të pasakta dhe çorientuese, duke ngritur dyshime serioze për përpjekje të mundshme për ta vënë në lajthitje AK-në dhe OSHP-në, për të ndikuar në vendimmarrjen e tyre dhe për të siguruar përfitime të kundërligjshme përmes paraqitjes së informacioneve të pasakta.

Veçanërisht shqetësuese janë kundërthëniet ndërmjet deklarimeve të PROGLOBAL-it, kalkulimeve të paraqitura prej tij dhe dokumentacionit që dëshmon çmimet reale të ofertave, si dhe lidhjet familjare dhe afariste të dokumentuara ndërmjet personave që qëndrojnë pas PROGLOBAL SH.P.K. dhe SAFETY 1ST L.L.C.

Këto rrethana kërkojnë trajtim serioz nga organet kompetente, veçanërisht kur në të njëjtin aktivitet prokurimi marrin pjesë dy operatorë ekonomikë, pronarët e të cilëve janë babë e bir. Ndonëse lidhja familjare, në vetvete, nuk përbën shkelje ligjore, ajo merr rëndësi të veçantë kur shoqërohet me rrethana konkrete që ngrenë dyshime për mungesën e pavarësisë së ofertave dhe koordinimin e veprimeve gjatë procedurës së prokurimit.

Në raste të tilla, koordinimi i mundshëm i ofertave mund të përdoret për manipulimin e konkurrencës dhe të rezultatit të procedurës së tenderimit, përmes mekanizmave të tillë si:

1. Krijimi artificial i kushteve për paraqitjen e një oferte si jonormalisht të ulët, duke krijuar një bazë të manipuluar për kontestimin ose eliminimin e një operatori konkurrues që ka ofertuar me çmim më të ulët.
2. Paraqitja e varianteve të ndryshme të produkteve ose shërbimeve përmes operatorëve të lidhur, me qëllim të anashkalimit të kufizimeve të përcaktuara në dosjen e tenderit, në rastet kur ofertat alternative nuk lejohen.
3. Tërheqja ose eliminimi i qëllimshëm i ofertës me çmimin më të ulët, për shembull, përmes mosdorëzimit të dokumenteve të kërkuara, me qëllim që kontrata ti jepet operatorit tjetër të lidhur, i cili ka paraqitur ofertë me çmim më të lartë.

Këta mekanizma përbëjnë forma të mundshme të koordinimit dhe manipulimit të konkurrencës, të cilat kërkojnë verifikim në rastet kur ekzistojnë indicie konkrete.

Një fakt veçanërisht i rëndësishëm, i dokumentuar në kërkesën tonë për rishqyrtim, është paraqitja nga PROGLOBAL e të dhënave të pasakta lidhur me çmimet e servisimit dhe mbushjes së aparateve kundër zjarrit, të cilat janë përdorur për të mbështetur pretendimet kundër ofertës sonë.

Siç kemi argumentuar dhe dëshmuar përmes provave konkrete, PROGLOBAL ka paraqitur kalkulime të kostos që nuk përputhen me natyrën dhe mënyrën e realizimit të shërbimeve, ndërkohë që vetë ka ofertuar çmime që bien në kundërshtim me pretendimet e tij. Këto kundërthënie ngrenë dyshime serioze për paraqitje të qëllimshme të informacioneve të pasakta, me synim diskreditimin e ofertës sonë dhe ndikimin në rezultatin e procedurës së prokurimit.

Të dyja çështjet janë trajtuar dhe mbështetur me prova dokumentare në kuadër të pretendimeve nr. 2 dhe nr. 3 të kërkesës për rishqyrtim të datës 12.10.2026.

Provë: Kërkesa për rishqyrtim e datës 12.10.2026.

Qëllimi i këtyre sqarimeve nuk është zgjerimi i objektit të ankesës, por evidentimi i kontekstit në të cilin janë ngritur pretendimet kundër ALBKOS SAFETY SH.P.K. dhe i ndikimit të mundshëm të informacioneve të kontestuara në procesin e vendimmarrjes së Autoritetit Kontraktues.

Për këtë arsye, kërkojmë që OSHP-ja të përqendrohet në dy pretendimet kryesore të paraqitura në vijim.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1

Mosshqyrtimi i duhur i kërkesës për rishqyrtim dhe mungesa e arsyetimit të vendimit refuzues, në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prizrenit, përmes vendimit të datës 13.10.2026, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 12.10.2026, pa i shqyrtuar dhe pa iu përgjigjur në mënyrë substanciale pretendimeve ankimore, argumenteve dhe provave të

paraqitura.

Në vendimin refuzues, AK-ja është kufizuar në përsëritjen e arsyes së eliminimit, përkatësisht në konstatimin se nuk përmbushet kriteri minimal i përvojës profesionale në vlerë prej 52.500,00 €, pa trajtuar referencat e dokumentuara, pretendimin për moszbatimin e vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566 dhe pretendimet e tjera të ngritura në kërkesën për rishqyrtim.

Neni 108/A, paragrafët 9 dhe 12 të LPP-së, kërkon që refuzimi i kërkesës për rishqyrtim dhe vendimi i Autoritetit Kontraktues të jenë të arsyetuara. Një vendim që vetëm përsërit arsyen fillestare të eliminimit, pa shqyrtuar argumentet dhe provat me të cilat ajo kundërshtohet, nuk e përmbush kërkesën ligjore për arsyetim substancial.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, duke refuzuar kërkesën tonë pa kryer një shqyrtim të plotë, objektiv dhe të argumentuar të pretendimeve të paraqitura.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2

Moszbatimi i vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566, mosverifikimi efektiv i referencave dhe eliminimi i pabazuar i ALBKOS SAFETY SH.P.K.

Ky pretendim përbën vazhdim dhe konkretizim të pretendimit të parë të kërkesës sonë për rishqyrtim të datës 12.10.2026, duke u mbështetur në të njëjtat fakte, argumente juridike dhe prova dokumentare.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prizrenit, gjatë rivlerësimit të ofertave, nuk ka dëshmuar zbatimin e plotë dhe efektiv të vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566, duke eliminuar ALBKOS SAFETY SH.P.K. pa dokumentuar verifikimin e referencave dhe pa arsyetuar në mënyrë konkrete mospërmbushjen e kriterit minimal të përvojës profesionale në vlerë prej 52.500,00 €.

Siç kemi argumentuar në kërkesën për rishqyrtim, OSHP-ja nuk kishte urdhëruar eliminimin e ALBKOS SAFETY SH.P.K., por verifikimin e referencave pranë autoriteteve kontraktuese përkatëse, duke kërkuar shprehimisht:

“Të ndërmarrë të gjitha masat dhe të bëjë verifikim edhe te autoritetet kontraktuese për të cilat OE ka deklaruar se kontratat i ka të përfunduara dhe të kërkojë prej tyre dëshmi sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Megjithatë, në vendimin refuzues të datës 13.10.2026, AK-ja nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që vërteton kryerjen e verifikimeve pas nxjerrjes së vendimit të OSHP-së. Përkundrazi, është mbështetur në kërkesën për dokumente shtesë B47 të datës 30.06.2026 dhe në përgjigjen tonë të datës 03.07.2026, të cilat i paraprijnë vendimit të OSHP-së.

Veçanërisht kontradiktor është fakti se AK-ja, pas pranimit dhe shqyrtimit të këtyre dokumenteve, më 21.07.2026 e kishte shpallur ALBKOS SAFETY SH.P.K. tenderues të suksesshëm. Ndërsa gjatë procesit të rivlerësimit, pa identifikuar ndonjë verifikim të ri ose dëshmi konkrete që do ta arsyetonte ndryshimin e vlerësimit të mëparshëm, ka konstatuar se të njëjtat referenca nuk e përmbushin kriterin e kërkuar.

Për më tepër, në kërkesën për rishqyrtim kemi paraqitur referenca për shërbime të servisimit, mbushjes dhe mirëmbajtjes së aparateve kundër zjarrit, me vlerë të përgjithshme të deklaruar prej

60.133,80 €, pa përfshirë referencën e KEK-ut dhe kontratat e tjera që përmbajnë shërbime të instalimit, testimit dhe komisionimit të sistemeve të mbrojtjes nga zjarri.

Megjithatë, AK-ja nuk ka identifikuar se cilat referenca janë pranuar ose refuzuar, cilat vlera janë njohur dhe mbi çfarë përllogaritjeje është mbështetur konstatimi se nuk përmbushet kriteri minimal prej 52.500,00 €.

Në vendimin refuzues, AK-ja është kufizuar në konstatimin se: "Kontratat e furnizimit nuk tregojnë përvojë në servisimin dhe mbushjen e aparateve për zjarrfikës", pa shqyrtuar natyrën reale të shërbimeve të realizuara në kuadër të këtyre kontratave.

Emërtimi formal i një kontrate si kontratë furnizimi nuk e përjashton automatikisht mundësinë që, në kuadër të saj, të jenë realizuar edhe shërbime të dokumentuara. Për shembull, në referencën e KEK-ut kemi identifikuar veçmas shërbime të realizuara dhe të dokumentuara në vlerë prej 45.299,00 € neto.

Pranueshmëria e këtyre shërbimeve duhet të vlerësohet në bazë të përmbajtjes së tyre reale, periudhës së realizimit dhe kërkesave konkrete të dosjes së tenderit, e jo vetëm në bazë të emërtimit formal të kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk mund ta mbështesë eliminimin e një operatori ekonomik në dyshime të përgjithshme lidhur me vlefshmërinë ose pranueshmërinë e referencave, pa dokumentuar verifikimin efektiv të tyre, veçanërisht kur një verifikim i tillë është kërkuar shprehimisht nga OSHP-ja.

Këto veprime dhe mosveprime bien ndesh me nenin 52.7 dhe nenin 59 të LPP-së, si dhe me nenet 26.16 dhe 40.2.1 dhe dispozitat përkatëse të nenit 45 të Rregullores Nr. 001/2022, duke cenuar njëkohësisht parimet e përcaktuara në nenet 1, 6 dhe 7 të LPP-së.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se eliminimi i ALBKOS SAFETY SH.P.K. është i pabazuar, pasi AK-ja nuk ka dëshmuar as zbatimin e vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566 dhe as mospërmbushjen e kriterit të përvojës profesionale përmes një vlerësimi të plotë, objektiv dhe të dokumentuar.

Kërkojmë nga OSHP-ja që ta aprovojë këtë pretendim si të bazuar, ta anulojë vendimin e kontestuar dhe ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, duke obliguar AK-në të kryejë verifikimin efektiv të referencave, të arsyetojë individualisht pranueshmërinë e tyre dhe të marrë një vendim meritor në përputhje me dosjen e tenderit dhe dispozitat e LPP-së.

Prova: Kërkesa për rishqyrtim e datës 12.10.2026, vendimi refuzues i AK-së i datës 13.10.2026, si dhe referencat dhe dokumentacioni mbështetës i bashkëngjitur.

PËRFUNDIM

Bazuar në faktet, argumentet dhe provat e paraqitura, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prizrenit, i datës 13.10.2026, është i pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, për dy arsye kryesore:

1. Mosshqyrtimi i duhur i kërkesës për rishqyrtim.

AK-ja ka refuzuar kërkesën tonë të datës 12.10.2026 pa shqyrtuar dhe pa iu përgjigjur në mënyrë substanciale pretendimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura, në kundërshtim me kërkesat ligjore për arsyetimin e vendimit, të përcaktuara në nenin 108/A, paragrafët 9 dhe 12 të LPP-së.

2. Moszbatimi i vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566 dhe eliminimi i pabazuar i ALBKOS SAFETY SH.P.K.

AK-ja nuk ka dëshmuar kryerjen e verifikimit efektiv të referencave pranë autoriteteve kontraktuese përkatëse dhe ka konstatuar mospërmbushjen e kriterit minimal të përvojës profesionale prej 52.500,00 €, pa vlerësuar dhe arsyetuar individualisht pranueshmërinë e referencave të paraqitura.

Dokumentacioni ynë përmban kontrata me vlerë të përgjithshme të deklaruar prej 60.133,80 €, pa përfshirë referencat e tjera, të cilat gjithashtu kërkojnë vlerësim. Këto veprime dhe mosveprime bien ndesh me nenet 52.7 dhe 59 të LPP-së, si dhe me nenet 26.16, 40.2.1 dhe dispozitat përkatëse të nenit 45 të Rregullores Nr. 001/2022.

Veprimet dhe mosveprimet e AK-së cenojnë gjithashtu parimet e përcaktuara në nenet 1, 6 dhe 7 të LPP-së, që ndërlidhen me ekonomicitetin, efikasitetin, konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

KËRKESË DREJTUAR OSHP-së

Bazuar në arsyet, argumentet dhe provat e paraqitura më lart, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. Ta aprovojë ankesën e ALBKOS SAFETY SH.P.K. si të bazuar.
2. Ta anulojë vendimin refuzues të Autoritetit Kontraktues të datës 13.10.2026, si dhe vendimin për dhënien e kontratës të datës 05.10.2026.
3. Ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që të kryejë verifikimin efektiv të referencave pranë autoriteteve kontraktuese përkatëse, të vlerësojë dhe arsyetojë individualisht pranueshmërinë e tyre dhe të marrë një vendim të ri, të arsyetuar dhe të dokumentuar, në përputhje me dosjen e tenderit, vendimin e OSHP-së nr. 2026/0566 dhe dispozitat e LPP-së Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26/10/2026 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0826/2026, ndërsa me datë 30/10/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0826/2026, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe rekomandon që të respektohet vendimi i PSH-së.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "AlbKos Safety" SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0826 ka vlerësuar si në vijim:

OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Pretendimet e ngritura janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

"Mosshqyrtimi i duhur dhe mungesa e arsyetimit të vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së. Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prizrenit, përmes vendimit të datës 13.10.2026, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 12.10.2026, pa i shqyrtuar dhe pa iu përgjigjur në mënyrë substanciale pretendimeve ankimore, argumenteve dhe provave të paraqitura."

Përgjigje

Eksperti shqyrtues sqaron që sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), Autoriteti Kontraktues duhet të shqyrtoj kërkesën për rishqyrtim të ngritur nga ana e opertatorëve ekonomikë brenda afatit të përcaktuar me ligj, dhe i njëjti duhet të përgjigjet në pretendimet e ngritura përmes kësaj kërkese dhe në rastin e refuzimit të kërkesës ky refuzim duhet të arsyetohet dhe komunikohet me shkrim.

Sipas vendimit të AK-së si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim shihet se Autoriteti Kontraktues përmes këtij vendimi nuk ka bërë shqyrtim të pretendimeve të ngritura në kërkesën për rishqyrtim të operatorit ankues, por ka bërë një përshkrim/kronologji të aktivitetetit të prokurimit. Andaj, ky pretendim i ngritur nga ana e OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 2

"Moszbatimi i vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566, mosverifikimi efektiv i referencave dhe eliminimi i pabazuar i ALBKOS SAFETY SH.P.K. Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prizrenit, gjatë rivlerësimit të ofertave, nuk ka dëshmuar zbatimin e plotë dhe efektiv të vendimit të OSHP-së nr. 2026/0566, duke eliminuar ALBKOS SAFETY SH.P.K. pa dokumentuar verifikimin e referencave dhe pa arsyetuar mospërmbushjen e kriterit minimal të përvojës profesionale prej 52.500,00 €. Siç kemi argumentuar në kërkesën për rishqyrtim, OSHP nuk kishte urdhëruar eliminimin e ALBKOS SAFETY SH.P.K., por verifikimin e referencave pranë autoriteteve kontraktuese përkatëse, duke kërkuar shprehimisht: "Të ndërmarrë të gjitha masat dhe të bëjë verifikim edhe te autoritetet kontraktuese për të cilat OE ka deklaruar se kontratat i ka të përfunduara dhe të kërkojë prej tyre dëshmi sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit."

Përgjigje

Eksperti shqyrtues pasqyron që për këtë aktivitet të prokurimit, në lidhje me referencat e OE ankues si dëshmi për projekte të ngjashme sipas kërkesave të dosjes, ka një raport paraprak të lëshuar nga eksperti shqyrtues dhe po ashtu ka edhe një Vendim të Panelit Shqyrtues (PSH), me numër 2026/0566.

Sipas këtij vendimi, PSH ka kërkuar nga AK që të bëjë verifikimin e dëshmive të kërkuara sa i përket projekteve të ngjashme sipas nenit 52.7 të LPP-së dhe ky verifikim është kërkuar që të bëhet edhe tek ato autoritete kontraktuese për të cilat operatori ekonomik ka deklaruar se kontratat i ka të përfunduara.

Po ashtu, sipas vendimit PSH ka kërkuar që edhe sa i përket ofertës financiare, AK duhet të bëjë një sqarim rreth çmimeve jo-normalisht të ulëta si dhe të bëjë një hulumtim të tregut rreth kësaj dukurie e sidomos kur ka dyshime nga ndonjëra palë për çmime manipulative me qëllim të mbrojtjes së buxhetit.

Tutje, sqarojmë që sipas sistemit e-prokurimi dhe sipas përmbajtjes së njoftimit mbi vendimin e AK-së, letrës standarde për tenderuesin e eleminuar dhe përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim nuk është parë se AK ka vepruar sipas Vendimit të OSHP-së, sipas të cilit është kërkuar verifikim i referencave/kontratave dhe i çmimeve. Prandaj, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga ana e operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se lidhur me aktivitetin e "Mbushja dhe servisimi i aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare.(projekt 3 vjeqar)" me nr. të prokurimit: "622-26-3081-2-2-1, ka pasur vendim të nxjerrur nga OSHP me nr. 2026/0566 më dt. 21.09.2026 Paneli shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore të cilat i ka paraqitur pala me ankesë, janë pretendime të cilat janë shqyrtuar nga ky paneli shqyrtues dhe për këto pretendime paneli në vendimin 2026/0566, ka vepruar duke u mbështetur në kërkesat e Dosjes së Tenderit, me çrast në atë kohë OE i rekomanduar, tani OE ankues në ofertën e tij, sipas këtij vendimi ishte konstatuar se " *futja e një numri të madh me kontrata të cilat nuk i përkasin kësaj natyre apo kontrata të cilat ende nuk ja përfunduar, apo kontrata të cilat janë përfunduar por dëshmit nuk i kanë sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit, lë shumë dyshime për të cilat AK konform nenit 52. 7 duhet ti ndërmarrë të gjitha masat dhe të bëjë një verifikim edhe tek autoritet kontraktues për të cilat OE i rekomanduar ka deklaruar se kontratat i ka të përfunduar dhe të kërkoj dëshmi prej tyre sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit*". Dhe paneli shqyrtues konsideron se për këto veprime AK mund ti ndërmarrë në secilën rast, nëse ata konsiderojnë se kanë dyshime. Po ashtu, paneli shqyrtues në vendimin paraprak pretendimin rreth mundësisë së çmimeve manipulative dhe jo-normalisht të ulët e ka konsideruar si pjesërisht të bazuar.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, Paneli Shqyrtues konsideron se AK ka respektuar vendimin paraprak të OSHP me nr. 2026/0566 dhe ka kthyer lëndën në ri-vlerësim dhe gjatë rivlerësimi komisioni i ri-vlerësim duke respektuar edhe vendim e OSHP ka konsideruar se OE ankues

ALBKOS SAFETY SHPK nuk e plotëson kërkesën e DT sa i përket kontratave të natyrës së ngjashme.

Për këtë paneli shqyrtues nuk ka si mos ta trajtoj ndryshme përveç çështje e gjykuar, konform nenit 105, paragrafi 2.16 të LPP, citat: "Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

Andaj, paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: "*Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës*", atëherë në zabim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit edhe më tutje (në pafundësi) dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që te mbetet ne fuqi vendimi i AK, siç përcakton edhe legjislacioni ne fuqi konkretisht neni 59 par. 4 te LPP-së, ku përgjegjesin ja atribuon autoritetit kontraktues, andaj mbetet ne përgjegjesi dhe diskrecion te Autoritetit Kontraktues aplikimi i kësaj norme, ashtu siç e përcakton edhe dispozita e referuar, pasi që këto pretendime (çështje) konsiderohen edhe si të gjykuara.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që

ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **ALBKOS SAFETY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: